

# DEKRIMINALIZIMI DHE INTEGRITETI

*DISKURSI PUBLIK, GJETJET DHE REKOMANDIME MBI  
PROBLEMATIKAT LIDHUR ME BILANCIN E  
LLOGARIDHËNIES SË ZYRTARËVE TË ZGJEDHUR*



*Ky material është përgatitur me mbështetjen financiare të NED.  
Pikëpamjet e shprehura janë përgjegjësi vetëm e ISP.*

## DEKRIMINALIZIMI DHE INTEGRITETI

### DISKURSI PUBLIK, GJETJET DHE REKOMANDIME MBI PROBLEMATIKAT LIDHUR ME BILANCIN E LLOGARIDHËNIES SË ZYRTARËVE TË ZGJEDHUR

*Raport monitorimi*

*Janar 2024*

*Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke monitoruar institucionet, partitë dhe zyrtarët e lartë të zgjedhur dhe të emëruar, si pjesë të angazhimit në projektin “**Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur**” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Pikëpamjet e shprehura në raport janë përgjegjësi e ISP-së.*

## HYRJE

Në Shqipëri, shpesh duke nisur që nga politikanët deri tek njerëzit e thjeshtë, çdokush akuzohet për korrupsion, lidhje me krimin dhe mungesë integriteti politik e qytetar. Ka kaç pak hapësirë për qytetarët, saqë edhe rolin demokratik që qytetarët duhet ta luajnë në mënyrë të vazhdueshme, veçanërisht përmes mekanizmit të zgjedhjeve, u shpërdorohet. Rastet e vjedhjeve, shitblerjeve, kërcënimeve gjatë votimeve, që kanë pas emra dhe mbiemra, nuk u duket fundi.

Në teorinë e demokracisë, në kutinë e votimit, qeveritë dhe individët që perceptohen gjerësisht se kanë vepruar me mungesë integriteti, duhet të ndëshkohen ashpër. Por, ky nuk është rasti i Shqipërisë. Ky raport hedh dritë mbi ligjërimin mediatik, teorik dhe opinionin publik lidhur me çështjet e integritetit, korrupsionit, ndikimit dhe besimit në politikë dhe politikanët në Shqipëri.

Tema që i bashkon të gjitha në këtë raport është dekriminalizimi. Pyetja më e parë që rrjedh nga kjo është se: në çfarë niveli është sot ligjërimi publik e politik mbi dekriminalizimin në Shqipëri? Ndërkohë që parimet e integritetit në politikë dhe në vendimmarrje, janë kusht dhe interes jetik për shtetin dhe shoqërinë shqiptare, a shohin qytetarët procesin vendimmarrës të pastër, transparentë dhe llogaridhënës? A po shkojnë normalisht politikanët nën hetim për korrupsion dhe inkriminim? A kemi deri më tani politikanë të dënuar sipas ligjit? Sa ndikojnë dënimet në shoqëri? A e justifikon drejtimi i sotëm i vendit këtë nivel sjellje të politikës? *“Kodet e sjelljes janë të nevojshme si politikat dhe procedurat... por për t'i zbatuar ato ju nevojitet një udhëheqje motivuese efektive”*<sup>1</sup>.

Përgjegjësia kryesore që bie për respektimin e standardeve të larta duhet të mbetet gjithmonë tek individi dhe më pas tek organizata (partia apo institucioni), ku bën pjesë. Megjithatë, historia aktuale tregon se vetë-rregullimi shpesh është i paefektshëm pa ndonjë formë të përfshirjes së jashtme. Është thelbësore që të kemi mekanizma që t'i mbajnë në vëzhgim ata që janë në poste publike për t'u kujtuar atyre rregullisht standardet për të cilat janë zgjedhur<sup>2</sup>. *“Çdo qenie njerëzore lind politike dhe ka pjesë në një bashkësi politike. Politika është e përfshirë në çdo veprimtari njerëzore. Aristoteli, pikërisht në njohjen e këtij realiteti të jetës njerëzore shkroi se: Të gjitha organizimet synojnë një të mirë; dhe organizata e veçantë, e cila është më sovranë nga të gjitha dhe, përfshin të tjerat, do të ndjekë këtë qëllim më së shumti dhe, vetëm kështu do t'i drejtohet më sovranit nga të gjitha të mirat. Organizimi më sovran dhe gjithëpërfshirës është polis, siç quhet, ose organizimi politik”* (Curtis, 1961:59).

---

<sup>1</sup> TNS BMRB, *Qualitative research on public perceptions of ethical standards in public life, report to the Committee, 2012.*

<sup>2</sup>[https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/228884/8519.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/228884/8519.pdf)

## I. HISTORIA E DEKRIMINALIZIMIT

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në dhjetor 2015 Ligjin nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, i njohur si ligji i “dekriminalizimit”. Ligji shqiptar përbën një model unik në kontinent dhe lidhet me kontestin politik të viteve 2011-2015. *“Në përpjekje për të promovuar rotacionin politik, partitë kryesore politike apo për të thyer bastione të njohura politike të së Djathtës, ish-opozita e viteve 2011-2013 promovoi në zgjedhjet lokale e parlamentare kandidatë me rekorde negative personale. Ata shiheshin si potencialet e vetme për të siguruar maksimizim të votave dhe për të ndikuar në rotacionin e ri politik”* (Krasniqi, 2018).

*“Nuk do zgjaste shumë dhe një numër politikanësh, me probleme me të shkuarën, do arrinin të fitonin poste qoftë në pushtetin lokal por edhe në atë qendror, si dhe në nivele të tjera më të ulëta. Këta individë i siguruan mandatet e tyre politike kryesisht përmes formave dhe metodave jodemokratike të konkurrimit, përmes kërcënimeve, shantazheve, frikësimit, blerjes së votës, konfliktit të interesave, dhe formave të tjera negative”* (Krasniqi, 2018).

Në vitin 2009 nisi procesi i prurjeve nga biznesi dhe ato vazhduan edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2011. Promovimi i personazheve me rekorde negative në poste të larta edhe të individëve me rekorde kriminale në të kaluarën, do përbënte një fenomen “interesant”, pasi ai do përcillej në formë zinxhiri. Kronika e lidh me rastin e bashkisë apo disa njësive vendore (komuna) në Kavajë, Tepelenë, Vlorë, Elbasan, Kukës, Shkodër, etj. Në vitin 2013 ky trend do rritej në masë gati drastike<sup>3</sup>.

Disa prej tyre arritën të fitojnë mandate të sigurtat parlamentare (u vendosën në vende fituese në listën shumë-emërore të partive politike, kryesisht të Partisë Socialiste) dhe u bënë pjesë e mazhorancës së re fituese në zgjedhje. Dyshime të arsyeshme se sistemi i ri paralel i promovimit bazohej në përzgjedhje klienteliste dhe raporte personale informale, në financime joligjore të fushatave dhe se mund të pasohet me akses të privilegjuar në fondet publike dhe politikën vendimmarrëse, dominuan debatet politike dhe publike të gjysmës së dytë të vitit 2014 dhe madje edhe periudhën deri pas zgjedhjeve lokale 2015.

Gjatë sesionit të dytë të vitit 2014 opozita parlamentare përfitoi nga disa raste flagrante të incidenteve në parlament për të bojkotuar parlamentin dhe për të nisur aksionin politik kundër dekriminalizimit. Në kulmin e debatit u shënuan disa incidente të rënda në parlament dhe

---

<sup>3</sup> <https://isp.com.al/wp-content/uploads/2018/02/DEKRIMINALIZIMI-GJENDJA-PROBLEMATIKA-DHE-PRITSHM%C3%8BRIT%C3%8B.pdf>

jashtë tij, kryesisht nga deputetë të akuzuar të mazhorancës, zhvillim që ishte përcaktues në shndërrimin e dekriminalizimit në temë dominuese të agjendës politike<sup>4</sup>.

Opozita insistoi tek komuniteti ndërkombëtar për ndërtimin e një ligji të ashpër kundër përfshirjes në politikë dhe administratë të individëve me rekorde kriminale në të kaluarën, në shkëmbim të rikthimit të saj në parlament. Oferta e saj mori mbështetje dhe në dhjetor 2014, dy partitë kryesore politike, Partia Socialiste në qeveri dhe Partia Demokratike në opozitë, u dakorduan në një marrëveshje politike për një bazë të ashpër ligjore kundër individëve me rekorde kriminale në politikë dhe në vendimmarrje. Marrëveshja pasoi me një debat të gjatë nëse vendosja e klauzolave së dekriminalizimit do të cenonin apo jo liritë kushtetuese.

Zgjidhja përfundimtare u dha nga Komisioni i Venecias, sipas të cilit<sup>5</sup>, *“mospasja të drejtë për t’u zgjedhur është një kufizim i së drejtës për zgjedhje të lira, ndaj ajo duhet të bazohet në norma të qarta të së drejtës, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të respektojë parimin e proporcionalitetit. Është në interesin e përgjithshëm publik shmangia e një roli aktiv të shkelësve në vendimmarrjet politike”*.

Mazhoranca e asaj kohe (PS) edhe pas këtij interpretimi “u mbrojt” duke e refuzuar kërkesën e opozitës dhe, duke mohuar rekordet kriminale në radhët e saj gjatë viteve 2014-2015 me justifikimin e prishjes së imazhit të vendit por edhe më akuzën e humbjes së mbështetjes popullore nga ana e opozitës. Faktet i hodhën poshtë argumentet e PS-së, që jo vetëm ndryshoi qasje në momentet e fundit nga faktet e sjella, por edhe e mbështeti marrëveshjen dhe më pas edhe ligjin.

Pas debatit të gjatë të palëve politike, ku u konsumua pothuajse një vit negociata, në dhjetor 2015 u miratuan ndryshimet në Kushtetutë (ligji 137/2015) dhe, më pas edhe ligjin organik (138/2015). Në Kushtetutë u përfshinë disa nene të veçanta. Sipas nenit 1<sup>6</sup> *“ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.”*

Sipas nenit 2, *“përrjashtohen nga e drejta për t’u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste*

---

<sup>4</sup> <https://isp.com.al/wp-content/uploads/2018/02/DEKRIMINALIZIMI-GJENDJA-PROBLEMATIKA-DHE-PRITSHM%C3%8BRIT%C3%8B.pdf>

<sup>5</sup> Raporti paraprak i Komisionit të Venecias, 30 Qershor 2015, fq. 34

<sup>6</sup> LIGJ Nr. 137/2015 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Fletore zyrtare, nr.219, 2015.

*përrjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike”<sup>7</sup>. Më tej i njëjti drejta Gjykatës Kushtetuese të interpretojë rastet e shkarkimeve të zyrtarëve të lartë që vijnë në kundërshtim me ligjin 138/2015, si dhe shtohet një nen tjetër, sipas të cilit “mandati i funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, që është fituar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbaron ose është i pavlefshëm kur konstatohet se i zgjedhuri ose i emëruari përfshihet në rrethin e subjekteve që janë të përrjashtuara nga e drejta për t'u zgjedhur”<sup>8</sup>.*

Ligji 138/2015 u miratua me konsensus politik dhe pati mbështetje të fortë ndërkombëtare. Në relacionin shoqërues dhe në hyrje të tij ligji përcakton synimet, qëllimin dhe parimet e zbatimit të tij. Sipas këtyre përcaktimeve, qëllimi kryesor ishte të realizonte: *“dekriminalizimin e organeve të zgjedhura, institucioneve të pavarura dhe administratës publike, si dhe mbrojtja në të ardhmen i funksionimit demokratik e ligjor të tyre, nëpërmjet largimit nga funksionit publik, apo pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, të personave me rekorde kriminale dhe/ose përdoruesve të substancave narkotike”<sup>9</sup>.*

## II. POLITIKA

Pse politika është e lidhur me këto fenomene dhe pse i tërheq personazhe të tilla? Kjo është një çështje që adresohet shpesh në demokracinë e sotme. Politika është *“arti i ndikimit, manipulimit ose kontrollit ... në mënyrë që të avancojë qëllimin e disave kundër kundërshtimit të të tjerëve”* (Wright, 1955: 130). Hans Morgenthau e sheh politikën si një *“luftë për pushtet”*, një luftë në të cilën konsideratat morale janë në varësi të diktateve të pushtetit (Morgenthau, 1973:27). Politika mund të shihet gjithashtu si *“procesi me të cilin çështjet agjitoohen përmes negociatave, argumenteve, diskutimeve, bindjeve dhe aplikimit të forcës”* (Djo et ai, 1965:6). Kur të gjitha konceptet e mësipërme merren së bashku, shfaqet një pamje specifike e politikës. Por, individët që duhet t'i drejtojnë këto procese përbëjnë rrezikun, që këto zhvillime të mos shkojnë normalisht.

Në një ekstrem, politika shihet si amorale, oportuniste dhe e përrshtatshme. Nga ana tjetër, shihet të jetë racionale, që përrfshin konflikte dhe bashkëpunim të rastësishëm, por që tek e fundit synon të mirën e shumicës. Kështu, politika paraqitet më mirë si *“një lloj loje, me rregulla, lojtarë, konkurrentë, fitues dhe humbës”*(Wynia, 1979:24).

---

<sup>7</sup> *Ibid*

<sup>8</sup> *Ibid*

<sup>9</sup> [https://www.dap.gov.al/images/LeqjislacioniAP/liqi\\_nr\\_138\\_dt\\_17.12.2015.pdf](https://www.dap.gov.al/images/LeqjislacioniAP/liqi_nr_138_dt_17.12.2015.pdf)

### III. INTEGRITETI

Integriteti, që duhet të kenë politikanët i referohet virtyteve të tilla si vërtetësia, sinqeriteti, ndershmëria, etj. Në aspektin politik, do të thotë që politikanët nuk duhet të jenë pretendues për gjëra të padrejta apo të korruptuar. Çfarëdo pasurie që ata mund të fitojnë duhet të përdoret për shkaqe të denja, sepse që virtytet e mësipërme të kenë kuptim në një komunitet politik, ato duhet të "*bashkohen me konceptimin e duhur të drejtësisë*" (Rawls, 1979:519).

Integriteti lidhet gjithnjë me etikën, sepse kjo e fundit këmbëngul që nga një individ të priten disa standarde të sjelljes. Kjo është veçanërisht e vërtetë sepse etika udhëheq marrëdhëniet njerëzore, veçanërisht marrëdhëniet me ata me të cilët punojmë ose jetojmë. Në parlamentin tonë, etika është një kategoritë e cila anashkalohe me së shumti. Etika kërkon që një individ të jetë i drejtë dhe të mos jetë i korruptuar; që fuqia dhe pasuria të përdoren me konsideratën maksimale ndaj drejtësisë dhe të drejtës. Prandaj, korrupsioni, ryshfeti, mashtrimi, krenaria dhe arbitrariteti nuk janë në përputhje me integritetin dhe pikërisht këto duhet të jenë në pasqyrën e vëzhgimit publik dhe institucional.

### IV. METODOLOGJIA

Për të pasur një panoramë të plotë të gjendjes dhe ligjëritimit politik e publik mbi këto tematika nuk mjafton vetëm analiza e qëndrimeve të partive politike apo deklaratimet e politikanëve, por edhe raportimi në mediat kryesore dhe vendi që zënë lajme të tilla në lajmet ditore politike. Duke pasur parasysh që shtypi shqiptar shfrytëzohet shumë nga politika dhe madje përmes saj parashtrihen lëvizjet e saj, në këtë raport jemi mbështetur në këtë qasje<sup>10</sup>. Ndaj, një pjesë e rëndësishme e këtij shqyrtimi është mbështetur në vëzhgimin tek media e shkruar (print), online dhe ajo vizive. Por shqyrtimi i shtypit, për shkak të stadiit të saj dhe problematikave, mund të jetë sipërfaqësor, i paplotë ose i ndërmarrë në shërbim të interesave ose agjendave të veçanta. Në këtë punim është pasur parasysh se Organizata "*Gazetarët pa Kufij*" në Treguesin Botëror të Lirisë së Shtypit, e renditi Shqipërinë dhe Kosovën në mesin e vendeve problematike. Megjithatë sipas indeksit që u publikua pak muaj më parë, edhe Shqipëria, edhe Kosova kanë shënuar rritje në krahasim me një vit më parë (2022).

Panorama e medias në Shqipëri shfaqet mjaft interesante dhe e gjallë: Botohen gati 20 gazeta ditore, 71 radio stacione, 70 stacione televizive dhe 109 televizione kabllorë dhe media të panumërta në internet. Por, brenda, në thelbin e saj, media elektronike dhe ajo e shkruar

---

<sup>10</sup> Mbështetur te <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14000.pdf>

rezultojn një biznes për interesa ekonomike dhe politike të një grushti pronarësh, që numërohen me gishtat e vetëm një dore<sup>11</sup>.

Për shqyrtimin në këtë raport janë monitoruar raportimet e mediave për ligjërimin politik: Top Channel, TV Klan, News 24, Ora News, ABC News, Gazeta Panorama, Gazeta Shqiptare, Shqiptarja.com, Gazeta DITA, Gazeta SOT, Portali Lapsi.al, Portali CNA, Portali Newsbomb, Portali Dosja, etj. Gjatë monitorimit janë verifikuar raportimi në media, gjuha dhe ligjërimi publik e politik i politikanëve, partitë politike institucionet e pavarura dhe deklarata të ambasadave të ndryshme të akredituara në Tiranë.

Temat e dekriminalizimit, integriteti në politikë, akuzat për lidhje të politikës me krimin apo të përfshirjes në korrupsion, kanë qenë temat dominuese të raportimeve mediatike mbi zhvillimet politike në periudhën shtator-dhjetor 2023. Roli i SPAK-ut në zhvillimet e muajve të fundit, zhvillimet në PD dhe në krejt opozitën shqiptare ishin kryefjala e muajve të fundit (Kryesisht atyre të katër muajve të fundit).

Gjatë vitit 2023 dhe, veçanërisht në muajt e fundit, Prokuroria dhe Gjykata e Posaçme u vunë në qendër të vëmendjes. Një numër i madh politikanësh, funksionarësh apo ish-zyrtarësh, të niveleve të larta të pushtetit qendror dhe atij vendor, u thërritën në SPAK. Por jo të gjithë dolën prej andej. Në një raport të përbashkët të *“Gazetarë pa Kufi”*- Gjermani dhe Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), Shqipëri, të publikuar në Mars të këtij viti, konstatohet që pronësia e medias elektronike dhe asaj të shkruar është *“ e përqendruar në duart e disa biznesmenëve të mëdhenj”*. Për pasojë, gazetarët për të ruajtur vendin e punës vetë-censurohen. Vetë-censurës i shtohet edhe pavarësia e limituar e redaktorëve. Janë pronarët e mediave ata që diktojnë përmbajtjen e produkteve të gazetarëve. Sipas raportit *“Kombe në tranzicion- Shqipëria 2018”* të Freedom House, *“ka një lidhje të ngushtë midis politikës, biznesit dhe medias”*. Kjo e bën të vështirë që media të luajë rolin e saj genuin si *“watch dog”*, pra të mbajë nën kontroll pushtetin dhe llogaridhënien e pushtetarëve<sup>12</sup>.

Arrestimet dhe hetimet që përfshinë emra të rëndësishëm të socialistëve, ishin goditje jo të vogla për shumicën në pushtet, e cila bëri disa ndryshime të detyruara në qeveri. Ndërkohë, që Opozita vazhdon të jetë e përçarë dhe në ditët e saj më të këqija, pavarësisht disa shenjave pozitive që po jepen në fund. Ish-kryeministri Sali Berisha përfundon po ashtu nën hetim, ndërsa sfida e tij ndaj gjykatës dhe Drejtësisë e ka marrë përgjigjen e refuzimit të tij, me masën e arrestit në shtëpi.

Debati **publik** e **politik** tregoi gjithashtu se edhe **opozita** dhe mazhoranca retorikën e dekriminalizimit e përdorin thjesht si fasadë e për konsum të jashtëm, ndërkohë që politikanë të

---

<sup>11</sup> <https://al.ejo-online.eu/media-dhe-politika/liria-e-medias/shqiperi-shtypi-pjeserisht-i-lire>

<sup>12</sup> <https://www.dw.com/sq/shqip%C3%ABri-liria-e-shtypit-pjes%C3%ABrisht-e-lir%C3%AB/a-43643428>



niveleve më të larta janë jo vetëm të përfshirë në akte korruptive, por edhe të akuzuar për korrupsion dhe me arreste me burg, arrest shtëpie apo shpejt do të kalojnë derën e burgut.

Mediat kanë raportuar në çdo rast për veprimet e SPAK-ut, ato të drejtësisë dhe rëndësinë e dekriminalizimit, por shpesh e zakonisht, ato përbëhen ose me deklarata të gatshme në zyrat e pushtetit apo partive politike, ose krejt asnjëse për raportimet, për të mos thënë se më shpesh u kanë bërë jehonë qëndrimeve politike të palëve.

Në këtë rast ato nuk kanë ushtruar pushtetin e tyre në favor të interesit publik, duke u bërë interprete të konflikteve politike si ndërmjet opozitës dhe pozitës, ashtu edhe palëve brenda PD-së, duke e mbajtur gjallë konfliktin në ligjërimin politik dhe duke i dhënë ushqim medias. Propaganda është përdorur nga qeveria si model qeverisjeje ndërsa nga partitë si mjet mbijetese politike të atyre dhe drejtuesve të tyre.

Ndërkohë, shpesh, mediat gjatë kësaj periudhe, në vazhden e nevojës për të pasur lajme dhe shikueshmëri apo klikime u kanë dhënë hapësirë palëve politike në konflikt, që të sulmojnë e denigrojnë kundërshtarët e tyre politikë, duke i bërë të përplasen me njëri-tjetrin duke krijuar mjegullnajë në informim, shpesh herë dezinformim, politizim të debatit dhe degradim të gjuhës e ligjërimin publik pa respektuar parimet etike të informimit dhe ato të komunikimit.